

20140411176

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR PRONËSI INDUSTRIALE

Neni 1

Në Ligjin për pronësi industriale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 21/2009, 24/11 dhe 12/14), në neni 10 në paragrafin (3) pika në fund të fjalisë shlyhet dhe shtohen fjalët: "në kohë prej katër vitesh".

Pas paragrafit (3) shtohen dy paragrafë të rinj (4) dhe (5), si vijojnë:

"(4) Drejtori dhe zëvendësdrejtori zgjidhen nëpërmjet shpalljes publike, të publikuar në tri gazeta ditore të cilat botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat njëra nga gazetat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(5) Drejtor dhe zëvendësdrejtor mund të emërohet personi që i plotëson kushtet në vijim:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim apo sanksion i kundërvajtjes ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- 3) ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK apo ka mbaruar shkallë VII/1;
- 4) të ketë minimum pesë vjet përvojë pune;
- 5) posedon njërën nga certifikatat vijuese të njohura ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:

- TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
- IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë,
- ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
- FCE (FCE) (Cambridge English: First) - të dhënë,
- BULATS (BULATS) - së paku 60 pikë dhe
- APTIS (APTIS) - së paku niveli B2 (B2) dhe
- 6) ka të dhënë test psikologjik dhe test për integritet".

Paragrafi (4) bëhet paragraf (6).

Neni 2

Drejtori dhe zëvendësdrejtori i Entit Shtetëror për Pronësi Industriale të emëruar deri në ditën e fillimit të zbatimit të nenin 1 të këtij ligji vazhdojnë ta ushtrojnë funksionin deri në përfundim të mandatit për të cilin janë emëruar.

Neni 3

Dispozitat nga neni 1 të këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me kushtin për njohje të gjuhës së huaj do të fillojnë të zbatohen pas dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.